BANKA E SHQIPËRISË

Revista Ekonomike

6M2-2020

Nëse përdorni të dhëna të këtij publikimi, jeni të lutur të citoni burimin.
Botuar nga: Banka e Shqipërisë,
Sheshi "Skënderbej", nr. 1, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
E-mail: public@bankofalbania.org

www.bankofalbania.org

** Pikëpamjet e shprehura në këto artikuj janë të autorëve, punonjës të Bankës së Shqipërisë, dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të institucionit.*

C O N T E N T

NJË VËSHTRIM STATISTIKOR DHE EMPIRIK MBI FLUKSET E REMITANCAVE *5*
Gerti Shijaku, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

AKUMULIMI I ASETEVE DHE BORXHIT TË FAMILJEVE NË VENDET PRITËSE TË REMITANCAVE: EVIDENCA NGA ANKETA E PASURISË SË FAMILJEVE SHQIPTARE *19*
Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 TEK REMITANCAT NË SHQIPËRI *29*
Margerita Topalli, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

NJË VËSHTRIM STATISTIKOR DHE EMPIRIK MBI FLUKSET E REMITANCAVE

Nga Gerti Shijaku[1], Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

SI T'I KUPTOJMË DHE MASIM REMITANCAT?

Domethënia ekonomike e remitancave, ose atyre që ndryshe njihen si dërgesa shoqërore, shkon përtej asaj që sugjerojnë statistikat zyrtare të bilancit të pagesave, si për vendet dërguese ashtu edhe për ato pranuese. Kuptimi ekonomik i remitancave rrjedh nga fjala "remit", që do të thotë të dërgosh mbrapsht. Termi që përdoret më shpesh në ditët e sotme për të përshkruar remitancat lidhet me fonde private, të cilat zakonisht kuptohen si paratë ose mallrat që dikush që punon jashtë vendit (migrantët) u dërgon anëtarëve të familjes dhe miqve në vendet e origjinës së lindjes, të cilat priren të shënjestrojnë nevojat specifike të marrësit dhe kështu mund të luajnë një rol efektiv në uljen e varfërisë [Ratha (2007)][2]. Mënyra më e zakonshme për të dërguar një remitancë është duke përdorur një sistem pagese elektronike përmes një banke ose një shërbimi transferimi parash nëpërmjet institucioneve që mundësojnë kryerjen e këtyre transfertave. Sipas Ratha (2020) është e vështirë të vlerësosh madhësinë e saktë të flukseve të remitancave sepse shumë transferime bëhen përmes kanaleve jozyrtare. Megjithatë, sipas saj një transaksion tipik i remitancave zhvillohet në tre hapa:

a) dërguesi migrant paguan remitancën tek agjenti dërgues duke përdorur para, çek, urdhër parash, kartë krediti, kartë debiti, ose ka udhëzime debiti dërguar me e-mail, telefon, ose përmes internetit;
b) agjencia dërguese udhëzon agjentin e saj në vendin marrës për të dorëzuar remitancën;
c) agjenti i pagimit bën pagesën te përfituesi.

Për zgjidhje midis agjentëve, në shumicën e rasteve, nuk ka transferim fondesh në kohë reale. Bilanci i detyruar nga agjenti dërgues tek agjenti i pagimit shlyhet në mënyrë periodike përmes një banke tregtare, ndërkohë që remitancat informale ndonjëherë zgjidhen përmes tregtisë së mallrave. Kostot e një transaksioni të remitancave përfshijnë një tarifë të ngarkuar nga agjenti dërgues, i paguar zakonisht nga dërguesi, dhe një tarifë konvertimi të monedhës për dorëzimin e monedhës vendase te përfituesi në vendin tjetër.

Sidoqoftë, vlerësimet globale të transferimeve financiare nga migrantët përfshijnë transaksione përtej asaj që zakonisht supozohet se janë dërgesat e parave, pasi përkufizimi statistikor i përdorur për mbledhjen e të dhënave për dërgesat e parave është më i gjerë [FMN, (2009)]. Gjithashtu, vlerësime të

[1] *Përgatiti Gerti Shijaku, Banka e Shqipërisë. Mendimet e Shprehura në këtë material janë vetëm të autorit dhe nuk përfaqësojnë mendimet apo opinionet e Bankës së Shqipërisë.*
[2] *Shih gjithashtu Adams dhe Page (2003); Adams dhe Page (2005); dhe Gupta, et al., (2009).*

tilla nuk përfshijnë transferime joformale. Remitancat mund të jenë gjithashtu të një natyre sociale, të tilla si idetë, sjellja, identitetet, kapitali shoqëror dhe njohuritë që migrantët fitojnë gjatë qëndrimit të tyre në një pjesë tjetër të vendit ose jashtë vendit, që mund të transferohen në komunitetet e origjinës [Levitt, (1998)]. Duke folur gjerësisht, çdo pagesë e një fature apo parash që i transferohet një pale tjetër mund të quhet dërgesë dhe si e tillë të përbëjë një nga format e njohura të remitancave. Metodologjia për regjistrimin e remitancave i klasifikon ato në tre zëra të bilancit të pagesave, si më poshtë:

a) "të ardhurat nga puna"- të ardhurat bruto të emigrantëve që jetojnë jashtë vendit për më pak se 12 muaj, duke përfshirë vlerën e përfitimeve në natyrë (klasifikuar në llogarinë korrente, nënkategoria "të ardhura nga puna";
b) "dërgesat e emigrantëve"- totali i transfertave monetare të dërguara në shtëpi nga emigrantët që jetojnë jashtë vendit për më shumë se një vit (klasifikuar në llogarinë korrente, nënkategoria "transferta korrente"; dhe
c) "transferta të emigrantëve"- vlera neto e transfertave nga migrantët që lëvizin nga një vend në tjetrin (klasifikuar në llogarinë kapitale, nënkategoria "transferta kapitale").

REMITANCAT SI ZË I BILANCIT TË PAGESAVE

Remitancat[3] përbëjnë një burim të rëndësishëm të ardhurash për financimin e kërkesës agregate dhe elemente të rëndësishme në kursimet familjare. Si të tilla, remitancat përbëjnë një zë të rëndësishëm në statistikat e bilancit të pagesave të Shqipërisë. Kjo vihet re nga pesha relative që ky zë vijon të ketë në terma të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) dhe treguesve të tjerë makroekonomikë. Të ardhurat nga remitancat (Figura 1) tregojnë se kontributi i tyre vijon të përbëjë fluksin më të madh hyrës në ekonominë shqiptare, duke lënë pas investimet e huaja direkte dhe eksportet e mallrave. Flukset e remitancave janë njëkohësisht fluksi financiar më i qëndrueshëm dhe më i sigurt në ekonominë shqiptare, në vite, duke tejkaluar edhe efektet pozitive të flukseve të tjera të kapitaleve të huaja. Të dhënat tregojnë se gjatë periudhës T1 2008 – T3 2020, raporti i remitancave ndaj PBB-së, ka shënuar vlerën 9.3%. Peshën më të madhe të remitancave e zënë ato të lidhura me transfertat personale të individëve dërgues. Ky tregues ka shënuar një rritje mesatare vjetore pozitive prej 4%. Kjo ishte një mbështetje mjaft e rëndësishme veçanërisht gjatë periudhës së vështirë ekonomike në vend të lidhur me goditjet negative të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia globale si pasojë e virusit COVID-19. Kjo konfirmon supozimet teorike se flukset e remitancave udhëhiqen nga prirjet kundraciklike, duke u rritur gjatë rënies ekonomike ose pas një katastrofe natyrore në vendet e origjinës së migrantëve, kur flukset private të kapitalit priren të ulen. Kuptueshëm, rëndësia e remitancave tregohet edhe nga efekti i saj në raport ndaj mbështetjes së rritjes ekonomike. Vlerësohet se zhvillimet negative lidhur me rritjen e remitancave gjatë periudhës T1 2009 deri më T4 2014 janë shoqëruar me rënien e ritmit rritës të PBB-së. Prirja e tyre rritëse gjatë periudhave

[3] *Përfshijnë të ardhurat parësore për "kompensimin e punonjësve"dhe "trasfertat jozyrtare nga të ardhurat dytësore.*

të mëpasshme duket se ka kontribuar pozitivisht në përmirësimin e rendimentit ekonomik në vend.

Figura 1. Flukset valutore në % ndaj PBB-së (djathtas) dhe rritja vjetore e remitancave dhe PBB-së reale (majtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT.

Gjatë periudhës T1 2008 – T3 2020, raporti i remitancave ndaj PBB-së ka shënuar vlerën mesatare 9.2%. Kjo peshë ka shënuar një rritje të lehtë në periudhën pas vitit 2017, duke vijuar mbështetjen e rëndësishme të këtij zëri në kuadrin makroekonomik të vendit. Rëndësia e tyre konfirmohet edhe nga raportet ndaj treguesve të tjerë. Së pari, brenda statistikave të llogarisë korrente, flukset e remitancave vijojnë të përbëjnë një mbështetje të rëndësishme financiare për mbulimin e deficitit tregtar. Në fund të T3 2020 (Figura 2), totali remitancave hyrëse ishin mesatarisht sa 42.1% e deficitit tregtar të mallrave. Nëse vendosen në raport me deficitin e përgjithshëm tregtar të mallrave dhe shërbimeve, raporti ngjitet në vlerën e 64.6% për të njëjtën periudhë. Raporti i kësaj ecurie ka qenë më i lartë se mesatarja e tij historike, duke filluar nga periudha T1 2015. Në të njëjtën kohë, raporti mesatar i remitancave ndaj eksportit të mallrave shënon vlerën 157.2% dhe ndaj investimeve të huaja direkte 128.4%. Kontributi i rëndësishëm makroekonomik i remitancave vihet re edhe në mbulimin pozitiv që shoqëron ecuria e tij ndaj dinamikës së deficitit të llogarisë korrente, duke gjetur një vend të vlerësueshëm për zbutjen e efekteve të tij. Në fund të periudhës T3 2020, deficiti i llogarisë korrente u zgjerua me 0.7 pikë përqindje ndaj PBB-së dhe kontributi i remitancave hyrëse në këtë drejtim vlerësohet rreth 0.5 pikë përqindje, ndërkohë që kontributi i të ardhurave nga eksportet ra me 5.6 pikë përqindje dhe ai nga IHD-të me rreth -0.6 pikë përqindje. Kjo është një tjetër dëshmi e vijimit të ndikimit të rëndësishëm që flukset e remitancave kanë për përmirësimin e ekuilibrit dhe dinamikës makroekonomike në vend. Kjo nënkupton se ruajtja e këtyre niveleve është mjaft e rëndësishme edhe për ruajtjen e nivelit të përgjithshëm të të ardhurave, konsumit dhe rrjedhimisht të rritjes ekonomike reale.

Figura 2. Raporti i remitancave ndaj treguesve të bilancit të pagesave.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

SJELLJA E REMITANCAVE: NJË ANALIZË EMPIRIKE

Shumë studime nxjerrin në pah përhapjen në nivel makro të remitancave. Roli që këto burime luajnë në promovimin e sipërmarrjes së emigrantëve, krijimin e komunitetit dhe familjes dhe integrimin politik është i njohur gjerësisht [Levitt, (1998)]. Sidoqoftë pak dihet se si faktorë të ndryshëm ekonomikë ndikojnë sjelljen e tyre në kohë. Analiza empirike është e pakët edhe për të kuptuar nëse sjellja e tyre në kohë është e qëndrueshme. Sikundër, edhe për të vlerësuar nëse persistenca e tyre ndaj goditjeve është e madhe apo nëse kthimi drejt një ekuilibri të ri kërkon më tepër kohë. Ky informacion është i pakët veçanërisht në rastin e një ekonomie të vogël të hapur, si ajo e Shqipërisë. Për këtë arsye, ky seksion fokusohet në adresim e katër hipotezave thelbësore, të cilat janë si vijon:

- A janë të qëndrueshme flukset e remitancave?
- A ndikohen flukset e remitancave nga sjellja autoregresive?
- A është e fortë persistenca e goditjeve ndaj remitancave?
- Cila është lidhja afatgjatë midis remitancave dhe treguesve kryesorë makroekonomikë të vendit dërgues dhe atij pranues?

Për t'u dhënë përgjigje këtyre hipotezave u ndoq një përqasje empirike, e cila fokusohet në specifikimin e modeleve të ndryshme, të cilat sipas rastit do të trajtohen më poshtë.

A JANË TË QËNDRUESHME FLUKSET E REMITANCAVE?

Në literaturë, trajtimi i konceptit të qëndrueshmërisë (stacionaritetit) të një treguesi makroekonomik të matshëm, përcaktohet si një proces i caktuar dinamik i rastësishëm, i cili mund të jetë i ndryshueshëm në kohë, nëpërmjet të cilit përfitohen disa vlera të ndryshueshme, të cilat supozohen se janë të qëndrueshme nëse vlerat e tyre vërtiten rreth nivelit të mesatares historike. Pra, ecuria e një treguesi cilësohet e qëndrueshme nëse trajektorja e ecurisë së tij qëndron rreth nivelit të mesatares së tij historike. Kjo nënkupton se norma më

të larta të tij në një periudhë kohore shoqërohen me nivele më të ulëta në një moment (periudhë) të mëvonshëm, dhe anasjelltas. Ky supozim mbështetet në teorinë e vlerësimit sipas metodës autoregresive të mesatares lëvizëse të njohur si metoda ARMA. Sipas kësaj metode, një seri thuhet të jetë (e dobët ose kovariancë) e palëvizshme nëse mesatarja dhe autokovarianca e serisë nuk varen nga koha. Çdo seri kohore që është e lëvizshme pranohet se përcaktohet nga njësia e rrënjës në seri. Në këto raste thuhet se seria është jostacionare. Për këtë arsye, për të analizuar qëndrueshmërinë e flukseve të remitancave zbatohet një përqasje vlerësuese sipas strukturës së tabelës së karakteristikave të rrënjës së njësisë[4]. Sipas kësaj përqasjeje mundësohet vlerësimi nëse treguesi i flukseve të remitancave ndaj PBB-së, apo edhe tregues të tjerë të lidhur me të, ndjek një trajektore të palëvizshme rreth një trendi mesatar ose linear, ose nëse është jostacionar për shkak të një rrënje njësie [Kocenda and Cerný, (2017)]. Në këtë rast, një seri e palëvizshme kohore është ajo ku vetitë statistikore, si mesatarja dhe ndryshimi i saj, janë konstante me kalimin e kohës. Sikundër vihet re nga Tabela 1, trajektorja e ecurisë së treguesve të lidhur me remitancat, si në rastin e atyre nga puna apo atyre nga transfertat ashtu edhe si vlerë totale e tyre, është pothuajse e njëjtë, por rezultatet e strukturës së karakteristikave të secilit prej këtyre treguesve janë të përziera. Nëse i referohemi vlerave statistikore P që lidhen me mundësinë e pranimit të hipotezës zero, kjo hipotezë hidhet poshtë në disa raste sipas të dhënave të testit ADF. Kjo do të thotë se mesatarja dhe autokovarianca e serisë së analizuar varen nga koha. Pra, këto seri kohore të lidhura me remitancat nuk janë të qëndrueshme. Rezultatet që mbështesin këto gjetje janë më të forta kur në metodën vlerësuese përfshihet një kostante ose një kostante dhe një trend. Mëgjithatë, nëse në metodën vlerësuese nuk përfshihen këto tipare, atëherë të dhënat e rezultateve janë më larg pranimit të hipotezës zero. Kjo do të thotë se sipas këtij vlerësimi, hipoteza zero mund të refuzohet, duke nënkuptuar se të dhënat e analizuara sipas këtij varianti janë të qëndrueshme. Sidoqoftë, në pjesën më të madhe, të dhënat e rezultateve sipas testit ADF kundërshtohen nga rezultatet e testit tjetër PP, veçanërisht në rastin e analizimit të flukseve të remitancave. Kjo do të thotë që konkluzioni nëse seritë kohore të lidhura me remitancat karakterizohen nga ekzistenca e rrënjës së njësisë nuk mund të jetë përfundimtar, pasi të dhënat e rezultateve paraqesin vlerësime të përziera.

Megjithatë, mungesa e një rrënje njësie nuk është një provë e stacionaritetit, por, sipas modelit të testit KSPP, kjo ka të bëjë me qëndrueshmërinë ndaj një prirjeje rritëse (rënëse) që shpjegohet nëpërmjet një përcaktuesi siç është trendi kohor. Ky është një dallim i rëndësishëm në analizimin e qëndrueshmërisë së serive kohore. Kjo për shkak se është e mundur që një seri kohore të jetë jostacionare (jo e qëndrueshme), pra të mos të karakterizohet nga tiparet e rrënjës së njësisë dhe përsëri të jetë stacionare në trend. Kjo për shkak se ashtu si në rastin e proceseve të serive të njësive të qëndrueshme apo të

[4] *Struktura e tabelës së karakteristikave të rrënjës së njësisë, e ndjekur më parë nga Shijaku (2012) për analizimin e qëndrueshmërisë e politikës fiskale, mbështetet në testin statistikor Augmented Dickey Fuller (ADF), Philip Perron (PP), dhe Kwiatkowski – Phillips – Schmidt – Shin (KPSS). Në ndryshim nga testet e tjera, testi KPSS e ngre hipotezën bazë nën supozimin se trajektorja që ndjek seria kohore e dhënë ka një prirje staticionare. Hipoteza alternative supozon se kjo trajektore është jolineare. Të dhënat janë tremujore. Në të gjitha rastet, vonesa kohore është një përzgjedhje optimale e metodës. Analiza vlerësuese përfshin periudhën T1 2008 – T3 2020.*

atyre të paqëndrueshme, mesatarja mund të rritet ose zvogëlohet me kalimin e kohës. Nga ana tjetër, në prani të një goditjeje, proceset stacionare të trendit kanë prirje të kthehen drejt mesatares historike (d.m.t.h në mënyrë kalimtare, vlerat që merr në kohë një tregues (seri kohore) mund të konvergojnë përsëri drejt mesatares rritëse, e cila nuk ndikohet nga goditja), ndërsa proceset e rrënjës së njësisë kanë një ndikim të përhershëm tek mesatarja (d.m.th. asnjë konvergjencë me kalimin e kohës). Prandaj, ashtu siç vihet re nga të dhënat e rezultateve të testit KPSS që raportohen në Tabelën 1, vlerat statistikore P në një pjesë të rezultateve janë më të vogla se vlera kritike (e raportuar në këtë tabelë) për nivelet e rëndësisë 10%, 5% dhe 1%, duke e bërë hipotezën zero të pranueshme në këto raste. Këto rezultate janë të njëjta veçanërisht në rastin e flukseve të vjetorizuara, të cilat supozohen se shprehin më mirë karakteristikat që lidhen me tiparet dalluese të pranisë së efekteve të mundshme të një trendi kohor. Kjo do të thotë se ekziston një trend i qëndrueshëm në rritje (ose zbritje) që shoqëron ecurinë dhe vetitë statistikore të këtyre serive në përgjithësi, i cili është konstant me kalimin e kohës. Kjo nënkupton se këto seri janë të qëndrueshme (të palëvizshme) rreth një trendi mesatar ose linear. Pra, mund të themi që këto seri janë stacionare jo për shkak të mungesës së rrënjës së njësisë, por për shkak të ecurisë së qëndrueshme rreth trendit. Prandaj, duke vlerësuar në përgjithësi rezultatet për shkak edhe të ndryshimit të rezultateve të testit ADF, PP dhe atij KPSS, mund të konkludohet se flukset e remitancave janë të qëndrushme (të palëvizshme) rreth një trendi përcaktues. Kjo e bën ecurinë e tyre mjaft të lehtë për të ndërtuar me saktësi pritjet ndaj tyre në të ardhmen, duke qenë se rezultatet e tjera bashkëplotësuese tregojnë se ecuria e tyre aktuale nuk përcaktohet nga thyerjet strukturore. Sikundër, në këtë drejtim edhe rezultatet e mëpasshme mbështetëse tregojnë se sjellja e tyre ndikohet në afatin e shkurtër nga sjellja autoregresive. Ky është një element tjetër mjaft i rëndësishëm që përcakton ecurinë e qëndrueshme të remitancave.

Tabela 1. Rezultatet e strukturës së karakteristikave të rrënjës së njësisë.

Treguesi	Karakteristika të veçanta	Augment Dickey-Fuller (ADF)		Phillips-Perron (PP)		Kwiatkowski-Phillips-Schmidt-Shin (KPSS)			
		Nivel	I(1)	Nivel	I(1)	Vlera Stat.	Vlera Kritike Asimptomatikea		
							1%	5%	10%
Remitanca (Total) ndaj PBB-së[b]	Kostante	.494	.000	.000	.000	.788	.739	.463	.347
	Kostante dhe trend	.632	.000	.000	.000	.220	.216	.146	.119
	Asnjëri	.024	.000	.317	.000				
Remitanca nga trasfertat ndaj PBB-së[b]	Kostante	.489	.000	.013	.000	.860	.739	.463	.347
	Kostante dhe trend	.825	.000	.000	.000	.293	.216	.146	.119
	Asnjëri	.012	.000	.239	.000				
Remitanca nga puna ndaj PBB-së[b]	Kostante	.505	.000	.000	.000	.448	.739	.463	.347
	Kostante dhe trend	.729	.000	.000	.000	.173	.216	.146	0.119
	Asnjëri	.495	.000	.180	.000				
Remitanca (Total) ndaj PBB-së[c]	Kostante	.446	.000	.432	.000	.827	.739	.463	.347
	Kostante dhe trend	.664	.000	.657	.000	.152	.216	.146	.119
	Asnjëri	.021	.000	.011	.000				
Remitanca nga trasfertat ndaj PBB-së[c]	Kostante	.419	.000	.421	.000	.889	.739	.463	.347
	Kostante dhe trend	.868	.000	.819	.000	.174	.216	.146	.119
	Asnjëri	.007	.000	.006	.000				
Remitanca nga puna ndaj PBB-së[c]	Kostante	.584	.000	.587	.000	.394	.739	.463	.347
	Kostante dhe trend	.849	.000	.849	.000	.112	.216	.146	.119
	Asnjëri	.552	.000	.546	.000				

a – Kwiatkowski-Phillips-Schmidt-Shin (1992)
b – lidhet me flukset e remitancave.
c – lidhet me stokun e vjetorizuar.

Burimi: Llogaritje të autorit.

A NDIKOHEN FLUKSET E REMITANCAVE NGA SJELLJA AUTOREGRESIVE?

Në statistikë apo dhe në analizat e përpunimit të serive kohore që lidhen me të dhënat makroekonomike, sjellja autoregresive përkufizohet si një proces i caktuar dinamik i rastësishëm që ndryshon me kohën dhe vlerat e përfituara prej tij varen në mënyrë lineare nga vlerat e mëparshme, ndoshta edhe duke përfshirë një term stokastik (një term i paparashikueshëm, i papërshtatshëm) të lidhura me treguesin në vetvete. Prandaj, për të analizuar sjelljen autoregresive të remitancave zbatohet një përqasje vlerësuese sipas strukturës së tabelës së dekompozimit të variancës[5]. Sipas kësaj përqasjeje mundësohet vlerësimi i ndikimit që treguesi i remitancave në vetvete apo secili prej komponentëve të tjerë makroekonomikë, qoftë i lidhur me vendin dërgues apo atë pranues, ka në trajektoren e flukseve të remitancave në një periudhë të caktuar kohore.

Sikundër vihet re nga Tabela 2, sjellja autoregresive e remitancave është e fortë në periudhat e afërta. Shpërndarja e kësaj sjelljeje vlerësohet se është relativisht e fortë brenda tre periudhave kohore. Pra, si e tillë ajo zgjat të paktën deri në tre tremujorë. Kjo nënkupton se vlerat e pritshme të flukseve të remitancave mund të parashikohen sipas një sjelljeje autoregresive bazuar në performancën e tij të kaluar, për të paktën 3 periudha në vijim. Kjo sjellje karakterizuese më pas zbehet duke marrë një peshë relativisht të vogël pas 12 periudhave. Për periudhat e tjera, pas periudhës së tretë, shpërndarja e faktorëve që përcaktojnë dinamikën e sjelljes së remitancaeve, vlerësohet se ndikohet relativisht më tepër nga zhvillimet që lidhen me treguesit e tjerë makroekonomikë. Një peshë veçanërisht të madhe në ecurinë e remitancave duket se e luajnë zhvillimet që lidhen njëkohësisht me rendimentin e prodhimit në vendet dërguese (e matur në këtë rast nëpërmjet PBB-së së Zonës Euro), dhe me atë në vendet pranuese (e matur në këtë rast nëpërmjet PBB-së së Shqipërisë). Treguesit e tjerë vlerësohen se nuk kanë ndikim në ecurinë e dinamikës së remitancave. Përjashtim në këtë trajektore përbën ecuria e kursit të këmbimit, i cili në periudhën e tretë arrin të shpjegojë deri në 11% të sjelljes së remitancave. Më pas efekti i tij zbehet. Këto rezultate nënkuptojnë se treguesit që ndikojnë trajektoren e remitancave lidhen veçanërisht me rendimentin e prodhimit në vendet dërguese dhe pranuese. Në të dyja rastet, efekti i tyre merr peshë veçanërisht pas periudhës së tretë. Pesha që zë efekti i ecurisë së prodhimit në vendet e Eurozonës është relativisht 3 herë më i madh se ai i Shqipërisë. Ky efekt arrin deri në 69% të shpjegueshmërisë. Sidoqoftë, nga pikëpamja e aspektit kohor, të dhënat e rezultateve tregojnë se në afatin e shkurtër pritjet mbi flukset e remitancave ndikohen nga sjellja autoregresive e tyre. Ndërkohë, në një horizont më të largët kohor, kjo prirje zhbëhet pasi rendimenti i prodhimit në vendin dërgues dhe atë pritës marrin një peshë më

[5] *Struktura e dekompozimit të variancës mbështetet në specifikimin e një modeli autoregresiv vektorial (VAR). Ky model përbëhet nga një sistem me më shumë se një ekuacion të ndryshimit stokastik të ndërthurur në më shumë se një ndryshore të rastit në zhvillim. Treguesit makroekonomikë të përfshirë në model përfaqësojnë totalin e remitancave (REM); PBB-në e Zonës Euro (PBBZE) dhe atë të Shqipërisë (PBB); normën vjetore të inflacionit të Eurozonës (PZE) dhe atë të Shqipërisë (P); kursin e këmbimit lekë – euro (EX); dhe një tregues për spread-in e normës së interesit vendas ndaj atij të Gjermanisë (s). Të dhënat janë tremujore. Analiza përfshin periudhën T1 2008 – T3 2020. Vonesa kohore është 4.*

të madhe dhe si të tillë janë përcaktues më të fortë ndaj kësaj sjelljeje. Këto rezultate janë të pritshme pasi lidhen me asimetrinë e informacionit. Kjo asimetri ndikohet nga disponueshmëria e informacionit mbi ecurinë e treguesve të tjerë dhe dinamika e ndërlidhjes midis treguesve makroekonomikë.

Tabela 2. Dekompozimi i Variancës sipas përqasjes VAR

Period	S.E.	REM	PBBZE	PBB	PZE	P	EX	s
1	0.0	100.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
2	0.0	63.3	10.3	9.7	7.6	4.9	4.2	0.0
3	0.0	43.8	10.0	24.9	6.2	3.4	11.1	0.6
4	0.1	16.5	55.2	21.3	2.0	1.8	3.0	0.2
5	0.1	12.0	57.7	22.4	0.9	0.9	5.8	0.2
6	0.2	10.7	62.2	19.5	0.4	3.4	3.5	0.2
7	0.4	5.9	69.0	21.1	0.4	1.0	2.5	0.2
8	0.4	6.0	66.3	19.1	0.2	4.4	3.5	0.5
9	1.0	4.6	68.3	23.9	0.3	1.0	1.7	0.2
10	1.1	4.6	64.1	21.6	0.3	4.6	4.1	0.6
11	2.8	4.8	68.9	23.6	0.2	1.0	1.3	0.1
12	2.9	4.5	63.2	22.1	0.4	4.1	5.1	0.7
Cholesky Ordering: REM PBBZE PBB PZE P EX s								
Burimi: Llogaritje të autorit.								

A ËSHTË E FORTË PERSISTENCA (MAGNITUDA) E GODITJEVE NDAJ REMITANCAVE?

Madhësia e përgjigjes afatgjatë të remitancave ndaj një goditjeje që merr një tregues tjetër makroekonomik i ndërlidhur me të, e njohur si qëndrueshmëria e goditjeve ndaj remitancave, është një çështje empirike e pastudiuar më parë në rastin e Shqipërisë. Siç është vënë re, edhe nga analiza e mësipërme, karakteristikat e remitancave luajnë një rol kryesor në hartimin dhe zbatimin e politikave makroekonomike dhe kanë pasoja të rëndësishme për sjelljen e agjentëve privatë. Duke u bazuar në supozimin e Willis (2003), persistencën e goditjes së remitancave e kemi përkufizuar si shpejtësia brenda së cilës flukset e tyre kthehen në rrjedhën e mëparshme ose në një nivel të ri ekuilibër pas një goditjeje. Pra, në këtë pikëpamje, persistenca e goditjes së tyre përkufizohet si efekti i vazhdueshëm i një goditjeje (shock) pafundësisht (shumë) të vogël që ndikon ecurinë e ardhshme të remitancave për t'u kthyer në ekuilibër, për të cilën mund të dallohen tre lloje të persistencës:

a. "korrelacion pozitiv serial në remitanca";
b. "vonesa midis veprimeve sistematike të politikave ekonomike dhe ndikimi (kulmimi) i tyre ndaj remitancave"; dhe
c. "përgjigjet e vonuara të remitancave ndaj veprimeve josistematike të politikave ekonomike makroekonomike".

Për vlerësimin e treguesit të llojit "a", ashtu si në rastin e Kota (2011), jemi bazuar në analizën sipas vlerësimit të thjeshtë të koeficientëve AR(1) dhe MA(1) të bazuar tek metoda Autoregresive e Mesatares Lëvizëse. Kjo metodë është përdorur gjerësisht për të matur inercinë e një treguesi makroekonomik. Në rastin tonë, kjo metodë u përafrua për të matur inercinë e remitancave. Për t'u siguruar që rezultatet tona nuk janë specifike për një matje të veçantë

të remitancave, analizojmë vetitë e dy treguesve të ndryshëm të tyre: flukset neto dhe flukset e vjetorizuara. Këta tregues shprehin ecurinë e remitancave për flukset nga puna, transfertat si dhe totalin e tyre.

Sikundër vihet re nga Tabela 3, rezultatet e parametrit AR(1) të shprehura nëpërmjet ρ tregojnë se persistenca e matur për periudhën [3] arrin në vlerën absolute 0.978 për flukset e remitancave totale, duke treguar se këto flukse shfaqin persistencë relativisht mjaft të lartë përgjatë kësaj periudhe. Kjo prirje vihet re edhe në rastin e llojeve të ndryshme të remitancave. Në rastin e remitancave, persistenca e tyre është më e lartë se ajo në rastin e totalit. Remitancat e vjetorizuara shfaqin një nivel më të lartë të persistencës krahasuar me flukset. Krahasuar me vlerësimin e mëparshëm, remitancat totale shfaqin një persistencë më të madhe. Megjithatë, krahasuar me kampionë të ndryshëm, persistenca e remitancave është më e fortë në periudhën [1], por më e vogël në periudhën [2]. Kjo tregon se persistenca e remitancave ka pësuar një tkurrje gjatë periudhës [2]. Kjo sjellje është më e lartë edhe kur përdorim të dhënat e vjetorizuara.

Siç argumenton Marques (2004), ekziston një lidhje e ngushtë midis persistencës së një treguesi dhe kthimit mesatar. Sipas tij, persistenca duhet vlerësuar duke pasur parasysh cilësinë e kthimit mesatar të serisë[6]. Seria që shfaq kthim mesatar të ulët, sugjeron Kota (2011), si rrjedhim përshkron mesataren pak më shpesh, duke nënkuptuar një persistencë më të madhe. Rezultatet e parametrit MA(1) tregojnë se vlera e tij absolute arrin 0.052 në rastin e remitancave totale. Kjo vlerë është relativisht më e ulët se ajo e remitancave nga puna dhe/apo atyre nga trasferta individuale. Remitancat nga transfertat e kanë vlerën e MA(1) më të madhe. Megjithatë, në të gjitha rastet vlera për secilin prej tyre përkon me atë të koeficientit ρ. Kjo konfirmon se persistenca e remitancave në secilin rast është e lartë.

Tabela 3. Rezultatet e persistencës (ρ) së remitancave sipas përqasjes AR(1), mesatare lëvizëse MA(1) në []

Treguesi [1] T2 2008 – T4 2013		Periudha		
		[2] T1 2014 – T3 2020	[3] T2 2008 – T3 2020	
Flukset ndaj PBB-së	PUNA	0.639	-1.000	0.862
		[-0.224]	[1.000]	[-0.671]
	TRANSFERTA	0.943	0.842	0.984
		[-0.677]	[-0.628]	[-0.694]
	TOTALE	0.938	0.853	0.978
		[-0.697]	[-0.752]	[-0.755]
Flukset e vjetorizuara ndaj PBB-së	PUNA	0.818	0.674	0.890
		[0.520]	[0.139]	[0.213]
	TRANSFERTA	0.979	0.904	0.989
		[-0.016]	[0.304]	[0.108]
	TOTALE	0.981	0.912	0.988
		[-0.127]	[0.064]	[-0.052]

Burimi: Llogaritje të autorit.

[6] *Siç sugjeron Kota (2011), kjo metodë klasike e paraqitur më sipër, supozon një mesatare konstante për të gjithë periudhën. Megjithatë, nuk mund të jetë gjithmonë kështu, prandaj një mesatare e ndryshueshme në varësi të kohës shfaqet të jetë më e dobishme se sa një mesatare konstante. Ky kufizim është i njëjtë edhe në rastin e parametrit* ρ.

Sidoqoftë, sipas sugjerimit të Kota (2011), persistenca e një treguesi të analizuar sipas metodës (a) nuk është një përcaktim i pranueshëm i persistencës. Së pari, deri këtu kemi të bëjmë me vlerësime të persistencës duke përdorur metodën me një variabël, ku literatura empirike supozon një nivel ekuilibër konstant afatgjatë të remitancave. Së dyti, parametri ρ jep informacion lidhur me madhësinë relative të ndikimit kumulativ të një goditjeje përgjatë serive, por nuk mund të mbështetemi në të për të marrë informacion për kohën relative të absorbimit të një goditjeje. Për të marrë informacion për këtë të fundit, duhet të mbështetemi tek treguesit. Për këtë arsye, përcaktimet e tjera të persistencës kanë të bëjnë me idenë e shpejtësisë, domethënë përgjigjes së remitancave ndaj një goditjeje. Nëse shpejtësia është e ulët, atëherë shpejtësia e kthimit në ekuilibër është e vogël, për pasojë themi se flukset e remitancave nuk janë (shumë) persistente, dhe anasjelltas. Prandaj, çështja e persistencës u pasua më tej me anë të metodës së mekanizmit të korrigjimit të gabimit (MVKG)[7], i cili paraqitet i vlerësuar në ekuacionin (1).

$$\Delta logREM = \underset{(-2.3)}{-0.128} * [logREM_{t-1} \underset{(-2.9)}{-0.306} * logPBB_{t-1}^{ZE} \underset{(-5.8)}{-0.317} * logPBB_{t-1} \tag{1}$$

$$\underset{(-3.0)}{+0.550} * P_{t-1}^{ZE} \underset{(-5.0)}{+0.502} * P_{t-1} \underset{(-4.7)}{-0.334} * EX_{t-1} \underset{(-2.2)}{+0.209} * s_{t-1} + 4.179]$$

Sikundër vihet re nga të dhënat e ekuacionit (1), rezultatet e parametrit MVKG[8] të shprehur nëpërmjet koeficientit α tregojnë se vlera e tij është -0.128. Madhësia e tij shoqërohet nga një vlerë statistikore, e shprehur në (), e cila është përafërsisht 2.3. Këto rezultate tregojnë dy karakteristika të rëndësishme. Në njërën anë, shenja negative që shoqëron vlerën e koeficientit α do të thotë se flukset e remitancave përcaktohen në afatin e gjatë nga ecuria e treguesve të tjerë makroekonomikë. Pra, edhe goditjet ndaj tyre pritet të përcaktohen njësoj nga kjo ecuri. Kjo nënkupton se ekziston një marrëdhënie afatgjatë dhe një vektor i korrektimit të gabimeve, që sjell flukset e remitancave përsëri në ekuilibër, në rast të një goditjeje ekonomike. Kjo marrëdhënie është gjetur se është e rëndësishme nga pikëpamja statistikore, duke qenë se vlera e koeficientit për të arritur në këtë përfundim është 2.3, pra më e madhe se 2. Pra, supozimi i Granger (1986) se ekuilibri afatgjatë midis treguesve të kointegruar midis tyre plotësohet dhe është i arritshëm, edhe në rastin e flukseve të remitancave. Kjo mbështet gjithashtu supozimin se flukset e remitancave përcaktohen njëkohësisht nga faktorët makroekonomikë të vendeve dërguese dhe atyre pranuese. Nga ana tjetër, megjithatë, magnituda e vektorit të korrigjimit të gabimit është relativisht e ulët. Vlera e saj prej 0.128 tregon se shpejtësia e kthimit në ekuilibrin e mëparshëm, apo drejt një ekuilibri të ri, në rast të një goditjeje ekonomike është relativisht e ulët. Kjo nënkupton se në rast të një goditjeje, çdo devijim nga niveli i ekuilibrit do të korrigjohet në një hapësirë relativisht më të gjatë kohore.

---

[7] *Kjo përqasje bazohet në supozimet dhe sugjerimet e Johansen, (1991), Johansen, (1992); Johansen, (1995); dhe Juselius, (2003).*

[8] *Rezultatet e testit të kointegrimit Johansen sipas kriterit Max-Eigenvalue mbështesin të paktën 1 vektor të mundshëm kointegrues të pranishëm në modelin e specifikuar sipas përcaktimeve me konstante dhe pa trend.*

Duke e përmbledhur, arrijmë në përfundimin se të dy matjet e persistencës së diktuar më sipër "shumës së koeficientëve autoregresivë" dhe "shumës së mesatares së kampionit", të cilave mund t'u referohemi si tregues bashkëplotësues të përafërt për një periudhë të caktuar, tregojnë se persistenca e remitancave është e lartë. Megjithatë, shpejtësia e kthimit të tyre drejt ekuilibrit të ri, apo edhe atij të mëparshëm, është e ngadaltë sipas asaj që sugjerohet nga metoda e "vektorit të korrigjimit të gabimit". Sidoqoftë, rezultatet konfirmojnë se ekuilibri i flukseve të remitancave është i lidhur ngushtë me faktorët makroekonomikë të vendeve dërguese dhe atyre pranuese.

CILA ËSHTË LIDHJA AFATGJATË MIDIS REMITANCAVE DHE TREGUESVE KRYESORË MAKROEKONOMIKË TË VENDIT DËRGUES DHE ATIJ PRANUES?

Analiza empirike për vlerësimin e lidhjes në afatin e gjatë midis flukseve të remitancave dhe treguesve të tjerë makroekonomikë u analizuan duke u mbështetur në ekuacionin (1) të paraqitur në seksionin më sipër. Ky ekuacion përfshin tregues të ndryshëm makroekonomikë të vendit dërgues dhe gjithashtu edhe tregues të tjerë të lidhur me vendin pranues. Pra, në këtë model, flukset e remitancave shprehen si funksion i rendimentit ekonomik dhe nivelit të çmimeve të vendit dërgues dhe atij pranues, kursit të këmbimit dhe spread-it të normave të interesit.

Sikundër vihet re nga të dhënat e ekuacionit (1), rezultatet tregojnë se flukset e remitancave ndikohen pozitivisht nga rendimenti i prodhimit. Rendimenti i prodhimit në vendin dërgues ka vlerën 0.306, ndërsa ai në vendin pranues arrin vlerën 0.317. Vlera e këtij treguesi në rastin e parë tregon se çdo përmirësim me 1 pikë përqindje në rendimentin ekonomik në vendet dërguese rrit flukset e remitancave në afatin e gjatë me përafërsisht rreth 0.306 pikë përqindje. Kjo do të thotë se flukset e remitancave përcaktohen nga niveli i të ardhurave në vendin dërgues. Kjo lidhje është e rëndësishme nga pikëpamja statistikore në nivel konvencional. Sikundër, edhe përmirësimi i rendimentit në vendin pranues u gjet se lidhet pozitivisht me flukset e remitancave. Të dhënat e rezultateve dëshmojnë se për çdo 1 pikë përqindje rritje në rendimentin e prodhimit në vendet pranuese, flukset e remitancave do të rriten me përafërsisht rreth 0.317 pikë përqindje. Kjo lidhje u gjet gjithashtu e rëndësishme nga pikëpamja statistikore. Lidhja pozitive midis tyre nënkupton se dërguesit e remitancave nxiten nga prirja e tyre për të investuar në vendet pranuese, nëse rendimenti i prodhimit në këto vende rritet. Për më tepër, lidhja midis tyre është relativisht më e fortë se ajo midis flukseve të remitancave dhe rendimentit të ekonomisë së vendit dërgues. Kjo nënkupton se flukset e remitancave nxiten më tepër nga prirja për të investuar se sa nga efekti i të ardhurave (mirëqenies).

Një element tjetër i rëndësishëm është edhe lidhja midis faktorëve të riskut dhe flukseve të remitancave. Së pari, ky aspekt analizohet nëpërmjet lidhjes midis flukseve të remitancave dhe nivelit të përgjithshëm të çmimeve në vendet dërguese dhe ato pranuese. Kjo lidhje gjendet se është negative në

të dyja rastet. Madje efekti i tyre u gjet se është gjithashtu i rëndësishëm nga pikëpamja statistikore. Madhësia e efektit është relativisht pak më e madhe në rastin e vendve dërguese. Sidoqoftë, në të dyja rastet, shenja e koeficientit që shoqëron këta tregues tregon se rritja e rrezikut, si pasojë e një rritjeje më të shpejtë të nivelit të përgjithshëm të çmimeve në secilin vend, redukton flukset e remitancave. Goditjet që lidhen me këtë efekt u gjetën se kanë ndikim relativisht më të madh krahasuar me treguesit e tjerë. Së dyti, ky efekt negativ u gjet gjithashtu edhe në rastin e analizimit të marrëdhënies afatgjatë midis flukseve të remitancave dhe rrezikut primar sovran. Ky rrezik matet nëpërmjet treguesit të diferencës (spread-it) së primit sovran i llogaritur si diferenca midis normës 12-mujore të bonove qeveritare dhe atyre të një vendi pa risk, siç është Gjermania. Rritja e këtij treguesi nënkupton se rreziku në vendet pranuese është më i madh se në ato dërguese, dhe anasjelltas. Për çdo 1 pikë përqindje rritje të këtij treguesi, flukset e remitancave bien me rreth 0.209 pikë përqindjeje. Kjo lidhje u gjet se është gjithashtu statistikisht e rëndësishme.

Së fundi, të dhënat e rezultateve të tjera paraqesin një marrëdhënie të drejtpërdrejtë midis forcimit të kursit të këmbimit dhe flukseve të remitancave. Për çdo 1 pikë përqindje forcim të kursit të këmbimit, flukset e remitancave u gjetën se ulen me përafërsisht rreth 0.334 pikë përqindje, dhe anasjelltas nëse vlera e monedhës vendase në treg zhvlerësohet. Kjo marrëdhënie u gjet se është e rëndësishme statistikisht në afatin e gjatë. Kjo do të thotë se ecuria e kursit të këmbimit është gjithashtu një tjetër përcaktues i rëndësishëm i flukseve të remitancave, i cili nisur nga shenja e koeficientit nënkupton se flukset e remitancave përcaktohen nga motivi për të mbështetur konsumin në kushtet e rënies së fuqisë blerëse si pasojë e zhvlerësimit të monedhës vendase.

KONKLUZIONE

Literatura teorike dhe empirike paraqet një shtjellim ezaurues të domedhënies ekonomike që flukset e remitancave kanë si për ekonominë në vendet pranuese në tërësi ashtu edhe për familjet në këto vende. Për këtë arsye, në këtë material analizuam një sërë karakteristikash të lidhura me flukset e remitancave. Të dhënat e rezultateve në secilin rast shpjegojnë një sërë çështjesh të rëndësishme të lidhura me qëndrueshmërinë e tyre, persistencën e goditjes dhe shpejtësinë e kthimit në ekuilibër në rast të një goditjeje ekonomike, si dhe të analizimit të marrëdhënies afatgjatë, nëse ekziston, midis flukseve të remitancave dhe treguesve makroekonomikë të lidhur me vendet dërguese dhe ato pranuese. Në secilin rast, analiza bazohet në të dhënat mbi ecurinë e këtyre treguesve pas krizës financiare globale.

Nga të dhënat e rezultateve në secilën analizë arritëm në përfundimin se flukset e remitancave vijojnë të përbëjnë një burim të rëndësishëm e të qëndrueshëm të ardhurash për financimin e kërkesës agregate dhe elemente të rëndësishme në kursimet familjare. Këto flukse vijojnë të përbëjnë një zë të rëndësishëm edhe në bilancin e pagesave si kontributori kryesor hyrës i flukseve valutore në ekonominë shqiptare, duke lënë pas investimet e huaja direkte dhe eksportet e mallrave. Kontributi i tyre vijon të jetë i rëndësishëm

edhe në aspektin e financimit të deficitit të llogarisë korrente, duke gjetur një vend të vlerësueshëm për zbutjen e efekteve të tij. Kjo nënkupton se ruajtja e këtyre niveleve është mjaft e rëndësishme edhe për ruajtjen e nivelit të përgjithshëm të të ardhurave, konsumit dhe rrjedhimisht të rritjes ekonomike reale. Të dhënat e rezultateve tregojnë gjithashtu se flukset e remitancave paraqiten të qëndrueshme (të palëvizshme) rreth një trendi përcaktues në afat të gjatë. Analizimi i karakteristikave të tjera tregoi njëkohësisht se ecuria e tyre në afatin e shkurtër ndikohet nga sjellja autoregresive, e cila është një tjetër element mjaft i rëndësishëm që konfirmon ecurinë e qëndrueshme të remitancave. Flukset e remitancave u gjetën se paraqesin një persistencë të fortë ngaj goditjeve, megjithatë shpejtësia e tyre e kthimit drejt nivelit ekuilibër vlerësohet se është relativisht e ngadaltë. Nga një anë, gjetëm se flukset e remitancave përcaktohen në afatin e gjatë nga një marrëdhënie e kointegruar me tregues të tjerë makroekonomikë. Në anë tjetër, gjetëm se në afatin e gjatë flukset e tyre ndikohen pozitivisht nga rendimenti i prodhimit në vendet dërguese dhe pranuese, por negativisht nga elementet e lidhura me rrezikun primar sovran dhe rritjen më të shpejtë të çmimeve. Në përfundim, gjetëm se këto flukse përcaktohen edhe nga faktorë të lidhur me nxitjen e tyre për të mbuluar rënien e fuqisë blerëse si pasojë e zhvlerësimit të monedhës në vendet pranuese.

LITERATURA

Adams Richard dhe John Page. (2003). "International Migration, Remittances, and Poverty in Developing Countries." World Bank Policy Research Working Paper 3179 (Washington).

Adams Richard dhe John Page. (2005). "Do International Migration and Remittances Reduce Poverty in Developing Countries?" World Development, Vol. 33(10): 1645–66.

FMN. (2009). "Balance of Payments and International Investment Position Manual" Sixth Edition (BPM6).

Gupta, Sanjeev, Catherine Pattillo, and Smita Wagh. (2009). "Impact of Remittances on Poverty and Financial Development in Sub-Saharan Africa." World Development, Vol. 31(1): 104–15.

Kocenda, Evzen, dhe Alexandr Cerny. (2017). "Elements of Time Series Econometrics: An Applied Approach." Karolinum Press.

Kota, Vasilika. (2011). "Persistenca e Inflacionit në Shqipëri." Banka e Shqipërisë 02(45)2011.

Kwiatkowski, Denis, Peter Phillips, Peter Schmidt, dhe Yongcheol Shin. (1992). "Testing the null hypothesis of stationarity against the alternative of a unit root." Journal of Econometrics, Vol. 54 (1-3): 159-178.

Johansen, Søren. (1991), "Estimation and Hypothesis Testing of Cointegration Vectors in Gaussian Vector Autoregressive Models." Econometrica, Vol. 59: 1551-1580.

Johansen, Søren. (1992), "Cointegration in Partial Systems and the Efficiency of Single-equation Analysis." Journal of Econometrics, Vol. 52: 389-402.

Johansen, Søren. (1995), "Likelihood-Based Inference in Cointegrated Vector Autoregressive Models." Oxford University Press, Oxford.

Juselius, Katarina. (2003), "The Cointegrated VAR Model: Econometric Methodology and Macroeconomic Applications." University of Copenhagen, July, 20th.
Levitt, Peggy. (1998). "Social Remittances: Migration Driven Local-Level Forms of Cultural Diffusion." The International Migration Review Vol. 32 (4): 926-948.

Marque, Carlos. (2004). "Inflation Persistence: Facts or Artfacts?" European Central Bank, Working Series No 371, June (2004).

Ratha, Dilip. (2007). "Leveraging Remittances for Development." Policy Brief, Migration Policy Intitute, June (2007).

Ratha, Dalip. (2020). "Remittances: Funds for the Folks Back Home." Finance & Development, Internation Monetary Fund, marrw nga world wide web datë 31.01.2021 në linkun e FMN-së https://www.imf.org/external/pubs/ft/fandd/basics/remitt.htm

Shijaku, Gerti. (2012). "Qendrueshmeria e borxhit publik ne rastin e Shqiperise." Banka e Shqipërisë.

Willis, Jonathan. (2003). "Implications of struktural changes in the US economy for pricing behaviour and inflation dynamics." Economic Review. First Quarter 2003, Vol. 88 (1): 5-27. Akumulimi i aseteve dhe borxhit të familjeve në vendet pritëse të remitancave: Evidenca nga Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare.

AKUMULIMI I ASETEVE DHE BORXHIT TË FAMILJEVE NË VENDET PRITËSE TË REMITANCAVE: EVIDENCA NGA ANKETA E PASURISË SË FAMILJEVE SHQIPTARE.

Ola Çami, Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

Remitancat luajnë një rol thelbësor në trajektoren e zhvillimit ekonomik të vendeve pritëse duke tërhequr vazhdimisht vëmendjen e politikëbërësve dhe kërkimit shkencor. Impakti i remitancave është shumëdimensional në jetën sociale, ekonomike dhe kulturore të familjeve dhe komuniteteve, të shtrira në afatin e shkurtër e në atë të gjatë. Pavarësisht analizave empirike të shumta të zhvilluara në dekadat e fundit, dinamikat mbeten të paqarta dhe nganjëherë kontradiktore, duke sugjeruar se remitancat mund të gjenerojnë si rezultate pozitive po ashtu rezultate negative për ekonomitë pritëse (Acosta, 2008; Adams dhe Cuecuecha, 2010; Garip, 2014) .

Debatet kryesore janë përqendruar në ndikimin që kanë flukset e remitancave në varfëri dhe në pabarazinë ekonomike. Në njërën anë, familjet që dërgojnë emigrantë dhe marrin dërgesa të parave gjenerojnë forma të reja të të ardhurave dhe kursimeve dhe si pasojë priren të jenë më pak të ndjeshëm ndaj goditjeve negative në ekonomi (Giles dhe Yoo, 2007). Në anën tjetër, disa studime sugjerojnë për efekte negative të remitancave dhe migracionit në investime si pasojë e faktit se remitancat kryesisht konsumohen (Rempel dhe Lobdell, 1978). Gjithashtu, disa studime kanë treguar se flukset e remitancave ulin pabarazinë e të ardhurave ose pasurisë (Adams 1992; Taylor 1992; Taylor et al. 2009), ndërsa të tjera vunë re të kundërtën (Mora 2005).

Kjo mungesë konsensusi mund t›i atribuohet së pari, larmisë së mjediseve të studiuara duke nxjerrë në pah rëndësinë e konceptimit të remitancave si një proces i ndikuar nga kontekstet e zhvillimit brenda vendeve pritëse (Docquiery et al., 2006) dhe së dyti metodologjisë së përzgjedhur dhe tipologjisë së të dhënave të përdorura. Një nga mënyrat domethënëse për të vlerësuar rolin ekonomik të remitancave është mbështetja në të dhënat e gjeneruara nga anketat të cilat kanë si qëllim mbledhjen e informacionit mbi të ardhurat, konsumin dhe pasurinë e familjeve në vendet pritëse. Këto anketa, të cilat marrin në konsideratë edhe flukset e remitancave në kanale joformale, tentojnë të dëshmojnë shpesh se remitancat janë një element kritik i mbijetesës dhe vendimmarrjes ekonomike për shumë familje të varfra (Rodriguez (1996) Cox, Eser and Jimenez (1998) Brière et al. (2002)).

Në Shqipëri, remitancat përbëjnë mbi 10% të PPB së vendit (Banka e Shqipërisë, 2019) e për rrjedhojë analizat e detajuara të impaktit të tyre në jetën ekonomike janë thelbësore. Dushku (2019), e cila përdor të dhënat e "Anketës së Pasurisë së Familjeve Shqiptare për 2019", tregon se për familjet që marrin të ardhura nga emigrantët, remitancat janë një burim i rëndësishëm i të ardhurave duke përbërë mesatarisht 34% të totalit të të ardhurave mujore të familjes (mediana

22%), madje për 24,4% të familjeve ato janë burimi kryesor dhe i vetëm i të ardhurave. Në anën tjetër, studimi nuk gjen diferenca të rëndësishme mes familjeve që marrin remitanca dhe atyre që nuk marrin remitanca në terma të konsumit dhe shpenzimeve ose buxhetit por gjen diferenca në nivelin e kursimeve ku familjet të cilat marrin remitanca kursejnë mesatarisht më shumë sesa ato që nuk marrin remitanca. Gjithashtu, niveli i përfshirjes financiare është më i ulët për familjet pritëse të remitancave. Për rrjedhojë, në mënyrë indirekte, mund të presim që akumulimi i aseteve në familjet pritëse të remitancave të jetë më i lartë duke ndikuar nivelin e pasurisë neto (asete minus detyrime) të tyre.

Duke përdorur Anketën e Pasurisë së Familjeve Shqiptare, ky material ka për qëllim të pasurojë më tej diskursin e filluar në materialin e publikuar nga Dushku (2019) me të dhëna mbi asetet reale, financiare si dhe të borxhit, duke analizuar diferencat në akumulimin e pasurisë neto të familjeve. Ky material gjithashtu analizon pabarazinë e pasurisë në terma të totalit për të parë nëse ajo është ndikuar pozitivisht apo negativisht nga pagesat e emigrantëve.

PASURIA NETO E FAMILJEVE QË PËRFITOJNË REMITANCA

Pasuria neto e familjes përkufizohet si diferenca mes aseteve dhe detyrimeve të saj. Asetet përbëhen nga asetet reale (banesa kryesore e familjes, pasuritë e tjera të patundshme, automjetet dhe motomjetet, sendet me vlerë si bizhuteri, antike ose vepra arti dhe vlera e biznesit/bizneseve të familjes) dhe asetet financiare (depozitat, investimet kolektive, bonot dhe obligacionet, aksionet, para të cilat i detyrohen familjes, pensionet vullnetare dhe sigurimi i jetës). Në anketë, kategoria e detyrimeve përbëhet nga: borxhi formal (kredia hipotekare me kolateral banesën kryesore ose me kolateral pasuritë e tjera të patundshme, kredia konsumatore, kartat e kreditit, overdraft-i e të ngjashme) si dhe borxhi joformal (borxhi i cili përftohet nga miq ose të afërm të familjes me ose pa normë interesi kthimi).

Në Tabelën 1 më poshtë është paraqitur vlera e pasurisë neto mesatare (në mijë lekë) e dekompozuar sipas aseteve dhe detyrimeve për familjet (i) që marrin remitanca; (ii) që nuk marrin remitanca; (iii) totalin e familjeve, për të parë nëse ka diferenca në këto tregues në terma agregate.

Tabela 1. Pasuria neto e familjeve (vlera mesatare, mijë lekë)

	Familjet që marrin remitanca	Familjet që nuk marrin remitanca	Totali i familjeve
Banesa kryesore	5604	5868	5807
Pasuri të tjera të patundshme	3989	3916	3937
Automjete dhe Motomjete	466	622	589
Biznesi	1654	5245	4889
Sende me vlerë	80	94	89
Asetet reale total	7283	7948	7793
Asetet financiare total	349	583	525
Asetet totale	7316	7980	7825
Borxhi formal	206	545	492
Borxhi joformal	316	469	429
Pasuria neto	7294	7873	7738
Numri total i observimeve	536	1568	2104

Burimi: Banka e Shqipërisë "Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Nga të dhënat e paraqitura në tabelë, familjet që marrin remitanca duket të kenë mesatarisht një vlerë më të ulët në terma të aseteve totale sesa familjet të cilat nuk marrin remitanca. Këto diferenca janë të vogla dhe jo të rëndësishme në terma të pasurive të patundshme dhe aseteve në formën e automjeteve dhe motomjeteve, por janë veçanërisht evidente kur krahasojmë vlerën që familjet zotërojnë në formën e biznesit/bizneseve (70% më pak) dhe në formën e aseteve financiare (40% më pak).

Duke qenë se familjet të cilat zotërojnë remitanca kanë një normë më të ulët të përfshirjes financiare, ky rezultat është i pritshëm si në terma të aseteve financiare po ashtu edhe të borxhit formal. Familjet pritëse të remitancave duket se në përgjithësi mbartin një borxh total më të ulët (pothuajse sa gjysma e borxhit të familjeve që nuk kanë remitanca), duke qenë se edhe niveli i borxhit joformal është më i ulët për këto familje, duke nënkuptuar se këto familje kanë një nevojë më të ulët për financim. Në këtë kuadër, niveli i pasurisë neto të familjeve që marrin remitanca është mesatarisht më i ulët sesa i familjeve të cilat nuk marrin remitanca.

Në anën tjetër, nëse analizojmë normën e pjesëmarrjes së familjeve (të paraqitura në Tabelën 2 më poshtë) në zotërimin e formave të ndryshme të aseteve dhe borxhit, shohim se familjet që marrin remitanca kanë një normë pjesëmarrjeje më të lartë në asete reale e veçanërisht në zotërimin e banesës kryesore dhe pasurive të tjera të patundshme. Fatkeqësisht, nuk duket se këto familje të kenë zgjedhur të investojnë të ardhurat në formën e biznesit (shih më lart dhe në vlerë monetare), vendim i cili do të gjeneronte të ardhura shtesë në afatin e gjatë.

Tabela 2. Pasuria neto e familjeve (norma e pjesëmarrjes, % totalit)

	Familjet që marrin remitanca	Familjet që nuk marrin remitanca	Totali i familjeve
Banesa kryesore	93.0	92.6	92.7
Pasuri të tjera të patundshme	43.0	33.7	35.9
Automjete dhe Motomjete	33.2	38.3	37.1
Biznesi	6.2	14.7	12.7
Sende me vlerë	17.7	9.9	11.7
Asetet reale total	97.3	96.0	96.3
Asetet financiare total	13.6	16.0	15.5
Asetet totale	97.4	96.8	97.0
Borxhi formal	11.4	14.4	13.8
Borxhi informal	14.8	13.1	13.5
Pasuria neto	97.8	97.2	97.4
Numri total i observimeve	536	1568	2104

Burimi: Banka e Shqipërisë "Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Në anën tjetër, vëmë re se familjet të cilat marrin remitanca, edhe pse për vlera më të ulëta, kanë një normë të pjesëmarrjes më të lartë në borxhin joformal sesa familjet të cilat nuk marrin remitanca. Kjo nënkupton se familjet vërtetë kërkojnë më pak financim në terma të vlerës, por janë më të prirura në rast nevoje ti drejtohen të afërmve dhe miqve përkundrejt institucioneve financiare.

Një tematikë me rëndësi e cila ka ndezur debat mes ekonomistëve ka qenë dhe lidhja që ekziston mes pagesave të emigrantëve dhe pabarazisë ekonomike. Konkluzionet janë kontradiktore ku një grup studimesh gjejnë se remitancat ulin nivelin e pabarazisë si në terma të të ardhurave po ashtu dhe të pasurisë (Adams 1992; Taylor 1992; Taylor et al. 2009), ndërsa studime të tjera sugjerojnë për një rritje të theksuar të pabarazisë si pasojë e faktit që prurjet në të ardhura janë jopoporcionale mes familjeve (Mora, 2005) duke ndikuar negativisht në treguesit totalë.

Në këtë material janë përllogaritur koeficientët Gini të pabarazisë duke shfrytëzuar të dhënat që ofron anketa për të parë shkurtimisht dinamikat potenciale që remitancat mund të kenë në pabarazinë agregate. Kurbat e Lorenzit për secilën prej tre kategorive (i) familje që nuk marrin remitanca; (ii) familje që marrin remitanca; (iii) totali i familjeve janë vizatuar në Grafikun 1 më poshtë.

Grafik 1. Kurbat e Lorenzit për familjet që marrin remitanca dhe për ato që nuk marrin remitanca



Burimi: Banka e Shqipërisë "Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Koeficienti Gini per totalin e pasurisë neto është i barabartë me 0.419 ndërsa nëse e dekompozojmë për familjet që marrin remitanca dhe ato që nuk marrin remitanca, vlerat e përftuara të treguesit janë respektivisht 0.433 dhe 0.376 që nënkupton se pabarazia e pasurisë është më e ulët për familjet që marrin remitanca e për rrjedhojë kjo ka ndikim dhe në treguesin total të pabarazisë. Gjithsesi, për të arritur në një konkluzion përfundimtar, është e nevojshme që kjo analizë të shtrihet në kohë gjë e cila nuk është e mundur nga të dhënat e anketës.

PASURIA NETO E DEKOMPOZUAR SIPAS KARAKTERISTIKAVE SOCIO-DEMOGRAFIKE TË FAMILJEVE

Pyetjet që lindin natyrshëm në vijim të analizës së mësipërme janë: cilat janë karakteristikat socio-demografike të familjeve të cilat marrin remitanca; a janë ato më vulnerabil financiarisht; a mund të shpjegohet sjellja e tyre në terma të akumulimit të aseteve dhe borxhit nga këto karakteristika dhe së fundi a zotërojnë familjet që marrin remitanca më shumë asete dhe pasuri neto sesa

familjet që nuk marrin remitanca por që zotërojnë të njëjtat karakteristika socio-demografike me to?

Në këtë kuadër, hapi i parë është të analizojmë profilin e familjeve që përfitojnë remitanca dhe ku ndryshojnë ato nga familjet që nuk përfitojnë remitanca, në përpjekje për të shpjeguar rezultatet e gjeneruara në tabelat 1 dhe 2 më sipër. Dushku (2019) ndërton profilin e familjeve bazuar në nivelin e të ardhurave dhe shpërndarjes gjeografike. Bazuar në informacionin e mundësuar nga vrojtimi, në këtë material është vlerësuar me rëndësi të vijohet analiza për treguesit: numri i anëtarëve të familjes, mosha e kryefamiljarit, burimi kryesor i të ardhurave, zona urbane/rurale, statusi i punësimit të kryefamiljarit si dhe niveli i arsimit të kryefamiljarit, të cilët mundësojnë ndërtimin e një tabloje më të plotë të familjeve pritëse të remitancave. Në Grafikun 2 më poshtë janë prezantuar karakteristikat socio-demografike të familjeve i) që marrin remitanca; ii) që nuk marrin remitanca; (iii) totali i familjeve, shprehur në përqindje ndaj totalit brenda secilit grup.

Grafiku 2. Karakteristikat socio demografike të familjeve që marrin remitanca



Burimi: Banka e Shqipërisë "Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Nëse krahasojmë karakteristikat socio-demografike mes grupeve, mund të themi se familjet pritëse të remitancave janë më të vogla mesatarisht në numër anëtarësh (47% e tyre përbëhet nga 1 ose 2 anëtarë përkundrejt 24.6%), jetojnë më shumë në zona rurale (38.3% përkundrejt 27.31%) dhe mosha e kryefamiljarit është mesatarisht më e lartë (41.5% janë mbi 65 vjeç përkundrejt 26%). Gjithashtu më shumë familje kanë si burim kryesor të ardhurash jo-punën (këtu përfshijmë dhe remitancat) dhe 43.5% e kryefamiljarëve janë në pension (përkundrejt 28.69% në familjet të cilat nuk marrin remitanca) gjë e cila është e lidhur me moshën mesatare më të lartë të kryefamiljarëve në këto familje. Gjithashtu, një numër më i madh kryefamiljarësh në familjet që marrin remitanca kanë një diplomë të arsimit jo-universitar (91.1%) përkundrejt atyre në familjet që nuk marrin remitanca (86.4%), edhe pse vihet re që dhe në terma të totalit kjo vlerë është e lartë. Bazuar mbi këto karakteristika, mund të themi se familjet që marrin remitanca janë familje më vulnerabël financiarisht ndaj goditjeve negative sesa familjet që nuk marrin remitanca. Për rrjedhojë, remitancat kanë një potencial të lartë të kontribuojnë pozitivisht në nivelin e varfërisë dhe mund të përmirësojnë ndjeshëm mirëqënien e tyre.

Në vijim krahasojmë nivelin e akumulimit të aseteve të familjeve që marrin remitanca përkundrejt atyre që nuk marrin remitanca dhe që gezojnë të njëjtat karakteristika socio-demografike. Këtu duhet theksuar përsëri se anketa nuk jep njohuri mbi kohëzgjatjen e prurjeve të remitancave për familjet që po studiojmë, si dhe që vrojtimi është zhvilluar vetëm në një valë duke mos na dhënë mundësi të ndjekim familjet në kohë (literatura empirike gjen një lidhje statistikisht të rëndësishme mes akumulimit të aseteve dhe numrin e viteve që familja ka marrë remitanca (De Haas (2009)). Komponentët e pasurisë neto të dekompozuar sipas karakteristikave të familjes dhe të kryefamiljarit paraqiten në tabelën 3 më poshtë.

Tabela 3. Pasuria neto sipas karakteristikave të familjes (vlera mesatare, mijë lekë)

	Familjet që marrin remitanca					Familjet që nuk marrin remitanca				
	Asetet reale	Asetet financiare	Borxhi formal	Borxhi joformal	Pasuria neto	Asetet reale	Asetet financiare	Borxhi formal	Borxhi joformal	Pasuria neto
Zona Gjeografike										
Urbane	8522	337	236	332	8556	8841	484	365	447	8863
Rurale	6479	361	185	304	6478	7593	628	606	484	7484
Numri i anëtarëve										
1 anëtar	6143	365	153	81	6168	4778	512	110	88	4764
2 anëtarë	6755	315	113	214	6742	7834	644	381	208	7872
3 anëtarë	7688	434	172	116	7740	7041	676	958	1030	6985
4 anëtarë	6810	408	236	605	6855	9180	559	394	320	8938
>4 anëtarë	8880	167	256	286	8867	8032	513	489	477	7983
Burimi kryesor i të ardhurave										
Të ardhura nga puna	9111	466	363	352	9140	7533	698	589	563	7522
Të ardhura jo nga puna	6490	266	248	837	6490	6964	321	490	211	6719
Mosha e KR										
<34 vjeç	4006	421	217	674	4054	6616	558	805	194	6417
35-44 vjeç	5176	613	433	529	5239	9652	692	450	794	9334
45-54 vjeç	10300	219	165	391	10400	7922	596	281	671	7892
55-64 vjeç	7771	366	121	244	7807	8534	622	905	274	8463
65-74 vjeç	7062	323	129	88	7033	7081	596	147	336	7143
>75 vjeç	6059	262	116	24	6050	6437	268	117	111	6426
Statusi i punësimit të KR										
I punësuar	7160	250	146	378	7165	7339	540	701	340	7127
I vetëpunësuar	7530	328	178	514	7580	11600	1006	330	896	11700
Pensionist	6702	305	230	89	6681	6817	356	406	284	6829
I papunë	9634	203	499	205	9669	6641	287	592	352	6550
Tjetër	4662	256	22	442	4739	6114	213	322	196	5796
Niveli edukimit të KR										
Niveli i I	7202	290	249	305	7214	6731	669	353	419	6744
Niveli i II	7459	416	167	222	7464	9345	439	689	569	9143
Niveli i III	7153	321	149	380	7182	8844	749	573	378	8696
I papunë & niveli I/IIedu	10700	403	499	205	10100	6622	318	599	341	6537
Pensionist & 1/2 anëtar	6639	358	133	74	6623	5820	554	284	157	5870

Burimi: Banka e Shqipërisë "Anketa e Pasurisë së Familjeve Shqiptare, viti 2019", llogaritje të autorit.

Vlerat e përftuara konfirmojnë rezultatet e mëparshme në lidhje më dinamikat e akumulimit të aseteve dhe borxhit për dy grupet në shqyrtim. Ajo çka mund të themi më tepër dhe që është në përputhje me sugjerimet teorike dhe empirike, është se familjet të cilat të ardhurat kryesore i kanë nga puna dhe që njëkohësisht marrin dhe remitanca, kanë akumuluar mesatarisht më shumë asete reale sesa familjet të cilat nuk marrin remitanca. Gjithsesi, nëse analizojmë këto tregues për dy grupimet më vulnerabil të vëzhguara "kryefamiljar i papunë pa diplomë universitare" dhe "familje me 1 deri ne 2 anëtarë me kryefamiljar në pension", vërejmë se familjet që marrin remitancat janë në një situatë më të favorshme në terma të aseteve, borxhit dhe pasurisë sesa ato familje të cilat nuk përftojnë remitanca.

KONKLUZIONE

Ky material analizon dinamikat që ekzistojnë mes pagesave nga emigrantët dhe efektit afatgjatë në akumulimin e aseteve reale dhe financiare, borxhit formal dhe joformal si dhe pasurisë neto të familjeve pritëse në Shqipëri. Analiza bazohet në të dhënat statistikore të Anketës së Pasurisë së Familjeve 2019 dhe vijon diskursin në materialin e Dushku (2019) mbi familjet dhe remitancat i cili fokusohet në efektet afatshkurta të tyre në të ardhura dhe konsum.

Të ardhurat nga emigrantët mund të kontribuojnë në të ardhurat totale të familjeve jo vetëm drejtpërdrejt, por edhe indirekt, duke ndikuar në gjenerimin e të ardhurave nga burime të tjera. Në planin afatgjatë, remitancat mund të financojnë akumulimin e aktiveve dhe duke ndikuar në shpërndarjen e të ardhurave dhe pasurisë së familjeve (Taylor,1992). Analiza sugjeron se familjet të cilat marrin remitanca janë më vulnerabil ndaj goditjeve ekonomike sesa familjet që nuk marrin remitanca bazuar në karakteristikat e tyre socio-demografike, e për rrjedhojë remitancat kanë një potencial të lartë të kontribuojnë pozitivisht në nivelin e varfërisë dhe mirëqenies së tyre.

Familjet që marrin remitanca kanë një normë pjesëmarrjeje më të lartë në asete reale e veçanërisht në zotërimin e banesës kryesore dhe pasurive të tjera të patundshme sesa familjet të cilat nuk marrin remitanca por mesatarisht zotërojnë një vlerë më të ulët në terma monetare të formën e këtyre aseteve. Veçanërisht në terma të biznesit/bizneseve familjare që ato zotërojnë, si norma e pjesëmarrjes po ashtu dhe vlera mesatare në lekë është ndjeshëm më e ulët (70% më pak) duke mbështetur hipotezën se familjet pritëse përgjithësisht nuk zgjedhin ti investojnë paratë e përftuara por ti konsumojnë ato (Adams, 1998 ; Adams dhe Cuecuecha, 2010). Në anën tjetër, si borxhi formal po ashtu dhe ai joformal është më i ulët për familjet të cilat përftojnë remitanca duke sugjeruar se edhe pse niveli i përfshirjes financiare është më i ulët, edhe nevojat për financim të tyre janë më të ulëta. Gjithsesi, familjet që kanë nevojë për financim janë më të prirura tu drejtohen për ndihmë miqve dhe të afërmve përkundrejt institucioneve krediduese.

Gjithashtu, ky material përdor dekompozimin e koeficientit Gini për të parë nëse remitancat sjellin një impakt pozitiv në zbutjen e pabarazisë totale dhe gjen se koeficienti Gini i pasurisë neto në familjet të cilat marrin remitanca është më i ulët e për rrjedhojë remitancat duket se kontribuojnë pozitivisht në shpërndarjen totale të pasurisë.

REFERENCA

Acosta, Pablo. «School attendance, child labour, and remittances from international migration in El Salvador.» Journal of Development Studies 47, no. 6 (2011): 913-936.

Adams, Richard H., and Zafar Mahmood. «The effects of migration and remittances on inequality in rural Pakistan [with comments].» The Pakistan Development Review 31, no. 4 (1992): 1189-1206.

Adams Jr, Richard H. «Remittances, investment, and rural asset accumulation in Pakistan.» Economic Development and Cultural Change 47, no. 1 (1998): 155-173.

Adams Jr, Richard H., and Alfredo Cuecuecha. «Remittances, household expenditure and investment in Guatemala.» World Development 38, no. 11 (2010): 1626-1641.

Cox, Donald, Zekeriya Eser, and Emmanuel Jimenez. «Motives for private transfers over the life cycle: An analytical framework and evidence for Peru.» Journal of Development Economics 55, no. 1 (1998): 57-80.

De Haas, Hein. «Remittances and social development.» Financing Social Policy, pp. 293-318. Palgrave Macmillan, London, (2009).

De la Briere, Benedicte, Elisabeth Sadoulet, Alain De Janvry, and Sylvie Lambert. «The roles of destination, gender, and household composition in explaining remittances: an analysis for the Dominican Sierra.» Journal of development Economics 68, no. 2 (2002): 309-328.

Docquier, Frédéric, Hillel Rapoport, and I-L. Shen. «Remittances and inequality: a dynamic migration model.» (2006).

Dushku, Elona. "Familjet dhe remitancat: Evidencë nga Vrojtimi mbi Financat dhe Konsumin e Familjeve Shqiptare." Diaspora dhe Pagesat, Banka e Shqipërisë (2019):35-44.

Garip, Filiz. «The impact of migration and remittances on wealth accumulation and distribution in rural Thailand.» Demography 51, no. 2 (2014): 673-698.

Giles, John, and Kyeongwon Yoo. «Precautionary behavior, migrant networks, and household consumption decisions: An empirical analysis using household panel data from rural China.» The Review of Economics and Statistics 89, no. 3 (2007): 534-551.

Rempel, Henry, and Richard A. Lobdell. «The role of urban-to-rural remittances in rural development.» The Journal of Development Studies 14, no. 3 (1978): 324-341.

Rodriguez-Clare, Andres. «Multinationals, linkages, and economic development.» The American Economic Review (1996): 852-873.

Taylor, J. Edward. «Remittances and inequality reconsidered: Direct, indirect, and intertemporal effects.» Journal of Policy modeling 14, no. 2 (1992): 187-208.

Stark, Oded, J. Edward Taylor, and Shlomo Yitzhaki. «Remittances and inequality.» The economic journal 96, no. 383 (1986): 722-740.

NDIKIMI I PANDEMISË COVID-19 TEK REMITANCAT NË SHQIPËRI

Margerita Topalli[1], Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë

1. HYRJE

Evropa dhe pjesa tjetër e botës po përjetojnë një tronditje të pajetuar ndonjëherë më parë. Pandemia Covid-19, e cila ka zënë në befasi ekonomitë e këtyre vendeve, ka shkaktuar një ndër krizat më të këqija globale. Asnjë vend, asnjë ekonomi, asnjë shoqëri nuk është kursyer dhe as Shqipëria nuk bëri përjashtim nga kjo.

Shqipëria hyri në këtë krizë menjëherë pas tërmetit shkatërrues të nëntorit 2019, duke e goditur edhe më shumë ekonominë, si dhe duke dobësuar qëndrueshmërinë e saj. Në mënyrë që Shqipëria, me një ekonomi në rënie dhe me parashikime negative të rritjes ekonomike, të përballojë këto ndikime negative të pandemisë COVID-19 dhe të parandalojë rënien ekonomike, e cila mund të shndërrohet në një depresion të zgjatur, duhet të ketë një rritje ekonomike shumë më të shpejtë.

Megjithatë, edhe para krizës së COVID-19, modeli i rritjes ekonomike shqiptare ishte i brishtë. Në vitin 2019, kontributi i investimeve ka qenë i kufizuar (Banka Botërore, 2020)2, ndërsa eksportet neto zbrisnin nga rritja ekonomike (niveli i lartë i importeve, dobësimi i BE-së si partneri kryesor tregtar). Në vend të kësaj, konsumi vazhdoi të ishte shtytësi kryesor i veprimtarisë ekonomike, i nxitur nga flukset hyrëse të remitancave dhe huadhënia e lartë e konsumatorit. Me shpërthimin e krizës COVID-19, ekonomia shqiptare, shumë e varur nga eksportet e shërbimeve, kryesisht nga turizmi, u prek dhe më shumë nga ndikimi ekonomik i kësaj krize. Deficite të konsiderueshme të llogarisë korrente (-7.6% të PBB-së), do të duhet të financohen. Në të kaluarën, remitancat dhe investimet e huaja direkte (IHD) ishin kanali kryesor i financimit, por që të dyja kanë parë një rënie të madhe.

Qëllimi i këtij studimi është që të vlerësojë ndikimin e pandemisë COVID-19 në trendin e remitancave në ekonominë e brendshme, të cilat kanë siguruar një burim të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm parash në rajon. Bazuar në praktikat më të mira të vendeve të tjera, ky studim gjithashtu ofron disa rekomandime se si kapitali financiar dhe njerëzor i diasporës mund të përdoret për qëllimin e rimëkëmbjes ekonomike, pasi përbën potencial të madh për zhvillimin e Shqipërisë.

---

[1] *Ky material nuk pasqyron domosdoshmërisht mendimet dhe pikëpamjet e Bankës së Shqipërisë, dhe as nuk janë të lidhura me konkluzionet e saj. Banka e Shqipërisë nuk është në asnjë mënyrë përgjegjëse për çdo përdorim të informacionit të dhënë.*

[2] *World Bank, 2020, http://documents1.worldbank.org/curated/en/301261588088338100/pdf/The-Economic-and-Social-Impact-of-COVID-19-Setting-the-Stage.pdf*

2. REMITANCAT GJATË PANDEMISË COVID-19

Remitancat kanë tendencën të luajnë një rol kundërciklik në një periudhë krize, ose të paktën kanë tendencën të mbeten një burim i qëndrueshëm financimi, por me pandeminë COVID-19, situata është atipike, sepse vendet dërguese dhe pranuese janë prekur për shkak të papunësisë ose të ardhurave të reduktuara. Kriza COVID-19 po çrregullon gjithashtu flukset e migracionit, rrjedhimisht potencialin e tyre për të dërguar remitanca, dhe në një farë mase funksionimin e shërbimeve të remitancave. Në këtë kontekst, mund të themi se humbja në dërgesat e parave të shkaktuara nga pandemia COVID-19 mund të vijë nga tre faktorë kryesorë: a) faktori ekonomik, b) faktori i migracionit, dhe c) çrregullimet që prekin ofruesit e shërbimeve të remitancave.[3]

Para se të fillonte kriza COVID-19, Banka Botërore kishte parashikuar që flukset e dërgesave të parave në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme (LMIC) të arrinin në 574 miliardë dollarë deri në fund të vitit 2020.[4] Por, ndërkohë që kriza pandemike e Covid-19 dhe ajo ekonomike vazhdojnë të përhapen, një studim i kryer në tetor 2020 nga Ratha et al.[5] parashikoi një humbje të thellë të flukseve të remitancave në LMIC (508 miliardë dollarë në vitin 2020 dhe një rënie të mëtejshme në 470 miliardë dollarë në vitin 2021).

Grafik 1. Remitancat në Shqipëri (BE, milion)



Burimi: Banka e Shqipërisë, 2020.

Me fillimin e krizës së COVID-19, me mbylljen ekonomike dhe recesionin e parashikuar global, vlerat e remitancave në Shqipëri filluan të bien, me një rënie të ndjeshme në tremujorin e dytë të vitit 2020 me gati 35% humbje vjetore (rreth 65 milionë euro). Në periudhën janar-shtator 2020, vlera e dërgesave të parave arriti në 471 milionë euro ose rreth 50 milionë euro (rreth 10%) më pak se në vitin 2019.

[3] *Marrë nga literatura mbi faktorët që ndikojnë në flukset e dërgesave të parave. Shikoni për shembull: Banka Botërore (2006) Implikimet Ekonomike të Remitancave dhe Migrimit (World Bank, 2006: Economic Implications of Remittances and Migration)*

[4] *Publikimi i të dhënave: Remitancat në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme në rrugën e duhur për të arritur 551 miliardë dollarë në 2019 dhe 597 miliardë dollarë deri në 2021 (worldbank.org).*

[5] *https://www.knomad.org/sites/default/files/2020-11/Migration%20%26%20Development_Brief%2033.pdf*

Kjo rënie e remitancave është shkaktuar pjesërisht nga ndikimi i fortë që kriza ka tek punëtorët migrantë, të përqendruar shumë në sektorët më të ndikuar; masave të kontrollit që kanë ngrirë shumë aktivitete ekonomike në vendet pritëse të diasporës; vështirësitë në rritje në qasjen e lehtësive të transferimit të parave; por edhe për shkak se një pjesë e rëndësishme e remitancave arrin përmes kanaleve informale.

Kjo rënie e fortë ka të ngjarë të ketë efekte negative në tregun e punës dhe konsumin personal, duke përkeqësuar kërkesën e brendshme dhe duke rezultuar në një rënie të PBB-së. Kjo humbje mund të rezultojë gjithashtu në një zgjerim të përkohshëm të deficitit të llogarisë korrente, parashikuar në 11% të PBB-së në vitin 2020, si dhe do të ushtrojë presion në tregun e këmbimit valutor.

Sidoqoftë, të dhënat e fundit sugjerojnë një trend më të nuancuar. Në fakt, sipas Bankës së Shqipërisë, në tremujorin e tretë të vitit 2020, remitancat duket se janë rikthyer në shuma më të larta se një vit më parë për të njëjtën periudhë. Ato gjithashtu priten të ngushtojnë deficitin e llogarisë rrjedhëse në 7.3% të PBB-së në vitin 2022.[6]

Rritja e remitancave përfaqëson një zhvillim shumë pozitiv për ekonominë shqiptare, pasi ato luajnë një rol kritik për anëtarët e familjeve të emigrantëve që kanë mbetur në vendet e origjinës. Së pari, këto transferime mund të ndihmojnë shumë familje të zbusin goditjet e pafavorshme makroekonomike, pasi disa prej tyre mund të jenë prekur shumë nga shpërthimi i COVID-19 (ose nga humbja e punës ose nga një rritje e shpenzimeve të kujdesit shëndetësor). Së dyti, duke marrë parasysh faktin që dërgesat e parave përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të PBB-së nominale të ekonomisë, si dhe efektin e tyre shumëzues në një ekonomi në vështirësi ku konsumi është i ulët, do të ketë një ndikim shumë më të madh në ekonomi, duke ndihmuar gjithashtu kontekstin makroekonomik:[7]

- politika fiskale (një rritje në ndikimin e konsumit në nivelet e PBB-së dhe TVSH-së),
- sektori financiar (lirim aksesi në kushtet e kredisë),
- politika monetare,
- tregu i punës (mbështetje për të vetëpunësuarit: burim financimi për biznesin e vogël).

[6] *https://ec.europa.eu/economy_finance/forecasts/2020/autumn/ecfin_forecast_autumn_2020_al_en.pdf*

[7] *Për efektet ekonomike të remitancave shih për shembull: OECD (2016) Remitancat Ndërkombëtare të Migrantëve dhe Roli i tyre në Zhvillim (OECD, 2016: International Migrant Remittances and their Role in Development)*

3. PËRMBLEDHJE E INICIATIVAVE AKTUALE DHE REKOMANDIMEVE KRYESORE

Ndërkohë që kriza COVID-19 po vijon, rezistenca e ekonomisë shqiptare po vihet në provë. Për të krijuar një ekonomi më të qëndrueshme, veprimet post-pandemike do të kërkojnë rregullime të mëdha në periudhën afatmesme (të tilla si: normalizimi i bilanceve, ulja e borxhit, rihapja e ekonomisë në mënyrë të sigurt dhe graduale, mbështetja e kërkesës agregate), të cilat duhet të merren në kohë, të jenë të shënjestruara si dhe transparente, në mënyrë që të mbështesin rimëkëmbjen dhe rritjen.

Remitancat, në kontekstin e zhvillimeve aktuale ekonomike, mbeten një potencial i madh për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik shqiptar, prandaj ato duhet të karakterizohen dhe trajtohen si resurse dhe si një kategori thelbësore në një ekonomi lokale.

Për rrjedhojë, në mënyrë që të lehtësohet transferimi i remitancave dhe të zbutet ndikimi i zvogëlimit dhe humbjes së tyre, përpjekjet përqendrohen në mekanizmat dhe masat e duhura për t›i mbështetur ato, si dhe në uljen e kostove të dërgesave përmes promovimit të përdorimit të kanaleve dixhitale.

Në këtë përpjekje, me qëllim ruajtjen e flukseve të dërgesave të parave, organizatat ndërmjetësе, përkatësisht: institucionet publike, grupet/organizatat e Diasporës, IOM, Banka Botërore, duhet të rrisin bashkëpunimin e tyre dhe të përfshihen në hartimin e rekomandimeve për masa konkrete për adresimin e dërgesave të parave. Shumica e tyre përpiqen të ulin koston e dërgimit të remitancave. Më poshtë, mund të gjejmë disa nga angazhimet ndërkombëtare për remitancat:

1. Grupe Ndërkombëtare të Punës u prezantuan për të ndihmuar komunitetin global me një përgjigje të koordinuar ndaj sfidave me të cilat përballen aktorët në fushën e remitancave.

a. Banka Botërore, gjithashtu krijoi një Grup Ndërkombëtar Pune për Përmirësimin e të Dhënave për Remitancat, përmes Programit Global të Njohurive për Migracionin dhe Zhvillimin (KNOMAD), me qëllim që të lejojë një monitorim më të mirë në kohë reale të flukseve të dërgesave; 8
b. Task Forca e Komunitetit për Remitancat u nis nga Fondi Ndërkombëtar për Zhvillimin Bujqësor (IFAD)[9].

[8] *Thirrja për të vepruar për remitancat në krizë: Si t'i mbani ato rrjedhëse në: https://www.knomad.org/covid-19-remittances-call-to-action*

[9] *Propozimi për veprim të Task Forcës së Komunitetit të Remitancave në: https://familyremittances.org/idfr-2020/the-remittance-community-task-force/*

2. Objektivi i G20:[10]

a. Përshpejtimi i përpjekjeve për të ulur koston e transferimeve të remitancave në më pak se 3% deri në vitin 2030, dhe për të eliminuar korridoret e dërgesave me kosto më të lartë se 5% (duke promovuar kanale digjitale si në dërgim ashtu dhe në marrje);
b. Përshpejtimi i përpjekjeve për të siguruar përfshirjen financiare (aksesi universal financiar, edukimi financiar, aftësitë dixhitale, adresimi i infrastrukturës dhe pengesat rregullatore).

Sa i përket Shqipërisë, ne duhet të specifikojmë që ndërsa krahasohet me fqinjët e saj në Ballkanin Perëndimor, Shqipëria ka zbatuar më shpejt dhe më strategjikisht, projekte të angazhimit të diasporës. Ministria e Diasporës ka bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare, Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, Bankën e Shqipërisë dhe sektorin privat për të zbatuar projekte që lehtësojnë dialogun me diasporën shqiptare dhe ulin barrierat burokratike në qeveri.

Duke pasur parasysh nivelet e larta të emigracionit dhe varësinë e madhe të shqiptarëve nga remitancat dhe investimet e drejtuara nga anëtarët e diasporës, ne mund të gjejmë më poshtë disa rekomandime, udhëzime të politikave dhe të organizatave ndërkombëtare, për t›i mbështetur ato dhe për të promovuar përdorimin e qëndrueshëm të kapitalit financiar dhe njerëzor të diasporës për zhvillimin ekonomik.

3. IOM Albania dhe institucionet e diasporës (SMD, NAD, NDF, ADBS, DPC, CAR)[11]:

a. lehtësim i angazhimit të komuniteteve të diasporës në vendin e tyre të origjinës për të promovuar zhvillimin shoqëror dhe ekonomik;
b. dizenjim dhe implementim i mekanizmave shtytës të investimeve, ConnectAlbania (krijimi i platformave të investimeve për bizneset e diasporës);
c. integrim i kapitalit njerëzor të diasporës përmes një databaze, e cila përmban informacion mbi aftësitë dhe përvojat profesionale të tyre (rrjeti profesional);
d. lehtësim dhe lejim i kalimit të shpejtë të know-how-it dhe të anëtarëve të Diasporës me aftësi të larta profesionale, në forcimin institucional dhe zhvillimin territorial.

[10] *Postimi i blogut të BB në: https://blogs.worldbank.org/psd/remittances-times-coronavirus-keep-them-flowing*
[11] *State Minister for Diaspora; the National Agency for Diaspora; the National Fund for Diaspora; the Albanian Diaspora Business Chamber and the Diaspora Publishing Center, the Center for Arbëresh Research*

4. Grupi i Bankës Botërore nënvizoi me përparësi disa rekomandime:

a. Projekti Greenback 2.0 në Shqipëri, në partneritet me Bankën e Shqipërisë (objektivi i përgjithshëm është ulja e kostove, bërja e transaksioneve më efikase dhe promovimi i edukimit financiar në të dy anët);
b. zbutja/eliminimi i detyrimeve fiskale për dërguesit dhe marrësit e remitancave;
c. promovimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet të gjithë aktorëve në proces;
d. përfshirja financiare e dërguesve dhe marrësve të dërgesave të parave;
e. promovimi i kanaleve dixhitale si në dërgim ashtu dhe në marrje, dhe përmirësimi i infrastrukturës së dërgesave.
(Gjatë vitit 2018, sipas Bankës së Shqipërisë, vetëm 7.5% e familjeve që marrin remitanca kanë një llogari bankare rrjedhëse dhe 6.2% e familjeve kanë një llogari kursimi. Edukimi financiar për orientimin dhe përdorimin e institucioneve bankare është ende në proces zhvillimi dhe maturimi.)

4. PËRFUNDIME

Në mënyrë të padiskutueshme, kriza COVID-19 ka qenë një goditje masive, por ndërsa përpiqemi të dalim prej saj, duke nxitur rimëkëmbjen, duke rritur produktivitetin dhe duke modernizuar ekonominë, është e një rëndësie thelbësore formulimi i një të ardhmeje më të mirë, më të barabartë dhe më të qëndrueshme. Është pikërisht kjo lloj krize që politikat mund ta kthejnë në oportunitet.

Kjo tronditje globale po çregullon dhe dërgesat e parave nga diaspora, të cilat janë një burim i rëndësishëm financimi për Shqipërinë, dhe po ushtron më shumë presion mbi financimin e llogarisë korrente dhe mbi stabilitetin e jashtëm. Rimëkëmbja 2021 dhe 2022 do të varet ndjeshëm nga sa mirë rigjallërohen flukset tregtare. Recesionet dhe rikuperimi i vonuar në vendet e BE-së, të cilat janë partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, dhe IHD-të dhe burimet e dërgesave të parave që ushqejnë konsumin, do të zbehin perspektivat e rritjes për ekonominë. Sidoqoftë, të dhënat e fundit tregojnë një rritje të remitancave gjatë tremujorit të tretë të vitit 2020, duke paraqitur një zhvillim shumë pozitiv për ekonominë shqiptare.

Prandaj, mund të konkludojmë se pandemia e koronavirusit ka nënvizuar edhe një herë rolin e Diasporës - duke ndihmuar në zbutjen e disa prej humbjeve sociale dhe ekonomike mes sfidave të shpopullimit në shkallë të gjerë - dhe na ka mësuar se rezultati do të jetë i dukshëm, vetëm përmes reagimit të përbashkët, të koordinuar dhe të përgjegjshëm.